

Switch® 62,5 WG

Lënda vepruese: Fludioxonil & Cyprodinil
PËRMBAJTJA: Fludioxonil: 25%
Cyprodinil: 37,5%
Lëndë ndihmëse: 37,5%
Numri i regjistrimit: AL: 274/ 08.10.2010
KS: 045-3952-2011/27.09.2011
Formulimi: Granula të dispergueshme në ujë

FUNGICID SPECIFIK, SISTEMI DHE KONTAKTI, ME VEPRIM PARAMBROJTËS DHE KURATIV, PËR KONTROLLIN E KALBËZIMIT GRI (*Botrytis cinerea*)

PËRDORIMI:

KULTURAT BUJQËSORE	SËMUNDJET	Doza	SASIA E TRETËSIRËS SPËRKATËSE (L/DYLYM)	KOHA E TRAJTIMIT
HARDHI	KALBËZIMI GRI (<i>Botrytis cinerea</i>)	80 - 100 gr/100 l ujë	80 - 100	Trajtime parambrojtëse kur kushtet janë të favorshme për zhvillimin e sëmundjes nga lulëzimi deri në pjekje.
LULESHTRYDHE	KALBËZIMI GRI (<i>Botrytis cinerea</i>)	80 - 100 gr/100 l ujë	80 - 100	Trajtime parambrojtëse kur kushtet janë të favorshme për zhvillimin e sëmundjes nga lulëzimi deri në pjekje.
DOMATE PATLIXHAN TRANGULL	KALBËZIMI GRI (<i>Botrytis cinerea</i>)	80 - 100 gr/100 l ujë	100 - 150	Trajtime parambrojtëse kur kushtet janë të favorshme për zhvillimin e sëmundjes.

VËREJTJE:

1. Numri maksimal i trajtimeve për çdo sezon, vresht 2, domate, patlixhan, trangull dhe luleshtrydhe 2-3.
2. Përdorni dozat e ulta në filimin e infeksionit. Dozat e larta përdoren në infeksione të rënda, duke bërë lagje të mire të masës vegetative dhe veçanërisht të frutave, por duke patur parasysh që doza të mos kaloj 120 gr/dylym.
3. Në vresht zgjidhni me kujdes fazën fenologjike kur do trajtoni në vartësi të rrëzikut të infeksionit dhe të programeve të trajtimeve të çdo zonë.
4. Për të evituar shfaqjen e rezistencës rekomandojmë alternimin e SWITCH-it me fungicide të tjera që kanë mënyrë tjetër veprimi.

MËNYRA E PËRDORIMIT: Me spërkatje.

MËNYRA E PËRGATITJES SË TRETËSIRËS SPËRKATËSE: Mbushni me ujë deri në mes pompën spërkatëse dhe filloni përzierjen. Hidhni dozen e duhur të preparatit duke vazhduar përzierjen dhe plotësoni pompën me sasinë tjetër të ujit. Tretësira spërkatëse mund të përdoret brenda 24 orëve nga koha e përgatitjes, duke bërë paraprakisht përzierje të mire.

SPËRKATJA E FUNDIT PARA VJELJES:

Hardhi: 21 ditë.

Domate, Patlixhan dhe Trangull: 7 ditë.

Luleshtrydhe: 14 ditë.

PËRZIHET me sukses me insekticidet dhe fungicidet e zakonshme. Në rast përzierje hidhni në fillim Switch veç rasteve kur preparati tjetër është formulim WSB (qese e tretshme në ujë).

FITOTOKSICITETI: Nuk është fitotoksik kur përdoret në kulturat dhe dozat e rekomanduara.

PERIUDHA E RUAJTJES: 3 vjet. Të ruhet në ambalazhin origjinal, në vende të mbrojtura nga dielli dhe lagështia,. Evitoni magazinimin në ambjentet me temperaturë nën -10°C dhe mbi 35°C.

MASAT PARAMBROJTËSE

-Të ruhet larg ushqimeve e pijeve për njerëzit si dhe ushqimeve për blegtorinë. -Gjatë përdorimit mos hani dhe mos pini lëngje e duhan. -Evitoni kontaktin e produktit me gojën, lëkurën, sytë dhe thithjen e pluhurit nëpërmjet frymëmarrjes. -Gjatë trajtimit vishni pajisjet mbrojtëse dhe i lani ato para se t'i ripërdorni. -Llani duart dhe pjesët e pambuluara të trupit para se të hani, të pini lëngje e duhan, si dhe me përfundimin e spërkatjes. -Përdoruesit e PMB-ve kthejnë ambalazhet e përdorura pranë njësive të tregtimit me pakicë, ku janë furnizuar.-Shkatërroni ambalazhin bosh sipas rregullave në fuqi.

UDHËZIME PËR NDIHMËN E PARË DHE KËSHILLA PËR MJEKUN:

-Në rast se dyshoni për helmim, ndaloni punën dhe kërkoni ndihmë mjekësore. Në rast kontakti me sytë ose lëkurën i lani menjëherë me ujë të bollshëm. Në rast gjëllitje i jipni sasi të madhe karboni aktiv me ujë të bollshëm. Mos u jipni asgjë nga goja, personave që kanë humbur ndjenjat. Nuk ka antidot specifik. Ndiqni mjekim simptomatik.
Tel. Urgjence: +44 1484 538 444.



Irritues për sytë



SHUMË HELMUES PËR PESHQIT DHE ORGANIZMAT UJORË.
Mos ndotni ujrat me preparatin ose ambalazhin e tij.

TË RUHET NË VENDE TË SIGURTA DHE LARG FËMIJËVE.

PRODHUESI: SYNGENTA Crop Protection AG,
Basel, Switzerland
Tel: +41 61 323 11 11 ; Fax:+41 61 323 12 12